



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 12.11. 2008, ora 12:20
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç,
Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa
Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Mbledhjen e monitoruan: përfaqësuesit e Presidencës së Kosovës, të OSBE-së
dhe të KDI-së.

- Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 3 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i disa peticioneve

Prof dr. Nerxhivane Dauti – Në cilësi të raportueses vuri në pah se ndërmjet Komisionit dhe organeve shtetërore ekziston një bashkëpunim i thellë, që po reflektohet në zbatimin e vendimeve. Tha se kemi falënderime nga qytetarët që na drejtohen lidhur me shërbimet që ua bëjmë. Shqyrtimin e ankesave të organit të shkallës së dytë e çmoi lart dhe kërkoi që këto vendime të jenë obligative. Lidhur me përmbajtjen e peticioneve theksoi se në shkresën nr. 0349/08, të datës 19. 6. 2008, të ushtruar nga Fatmir Pireci, nga Prizreni, në të cilën theksohet se KPMK-ja e ka miratuar ankesën e tij dhe ka kërkuar që ankuesi të kthehet në vendin e punës.

Komisioni konkludon që për realizimin e së drejtës lidhur me marrëdhënien e punës, ankuesi t'i drejtohet Gjykatës Komunale të Prizrenit.

Mehdi Restelica, nga Prishtina, me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. P-nr. 1982/06, të datës 20. 5. 2008, është shpallur fajtor, sepse prej datës 7. 9. 2006 deri më 11. 9. 2006, në Prishtinë, në lagjen "Emshiri" e ka kërcënuar seriozisht dhe me qëllim të frikësimit bashkëshorten e vet, Suzana Restelica, prej së cilës ka kërkuar të mos i përzihet në paratë e shtëpisë së shitur në Podujevë.

Gjykata, Mehdi Restelicës, ia ka shqiptuar dënimin për kanosje dhe ushtrim të dhunës në familje.

Komisioni konkludon që për realizimin e të drejtave, ankuesi për dënimin për kanosje dhe ushtrim të dhunës në familje, t'i drejtohet Gjykatës Komunale të Prishtinës.

3. Te ndryshme

Naim Rrustemi – ngriti dy çështje : E para të kërkohet sqarimi pse duhet që Agjencioni për Barazi Gjinore të funksionojë që gati dy vite me ushtrues detyre?

Kërkesa për shqyrtim të adresohet në institucionet përgjegjëse për funksionimin e ABGj.

E dyta të procedohet me thirrjen për dëgjim në Komision të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe të Rektorit të UP që të japin sqarime lidhur me peticionin që ende nuk është shqyrtuar. Nëse nuk kemi përgjigje nga institucionet përkatëse atëherë të mirren të gjitha masat që do të detyronin ata të u përgjigjen kërkesave të Komisionit.

Kryetari - Theksoi se së shpejti këtë çështje do ta kemi në rend dite, sepse askush nuk mund të jetë mbi ligjin.

Drita Maliqi – E ngriti çështjen e moszbatimit të Ligjit për barazi gjinore. Kërkoi nga Komisioni që këtë çështje ta ngritë në institucionet shtetërore, në mënyrë që femra të ketë përfaqësim të barabartë në të gjitha institucionet.

Sanije Alijaj - I propozoi Komisionit ta hartojë raportin e punës njëvjeçare lidhur me shqyrtimin e peticioneve. Në këtë kontekst, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës, e mbështeti dhe u angazhua për zbatimin e kriterëve të përfaqësimit të femrës në të gjitha nivelet institucionale. U angazhua edhe për mbajtjen e një tryeze të rrumbullakët që do të jepte rezultate lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për barazi gjinore. Pra, ishte mendim i përgjithshëm, pavarësisht nga Agjencia për Barazi Gjinore, të merren veprime për organizimin e dëgjimit publik. Kryetari dhe të tjerët u pajtuan për këtë.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 45.

E përgatiti:

Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri